



| | | | | |
|------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|---------------------|
| Pranimi / Dorezuar Prenjeto / Profato Received / Deliverty | 11. 06 | 2021 | 1 | viti god year |
| Organ / Njesia Organ / Jedinica Org./Unit | Nr. Pril. Br. Pril. Pril. No. | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity | |
| SKMBIK/3024/2021 | | | 113 | |



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.357/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetare, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën e datës 05.05.2021 me numër A.nr.357/2021 e parashtruar nga ankuesi me adresë: Rr. "Mbretëresha Teutë", Nr.109, Komuna e Obiliqit, kundër organit të punësimit Komuna e Obiliqit, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 11/06/2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.357/2021 e datës 05.05.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. SHFUQIZOHET Vendimi me Nr.III-125 i datës 21.04.2021 i Drejtoreshës së Administratës të Komunës së Obiliqit.
- III. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Obiliqit për zbatimin e këtij vendimi në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas Akt emërimit me numër II/21 të datës 03.01.2013 është i sistemuar në vendin e punës "Nëpunës për vërtetimin dhe saktësimin e dokumenteve", në Administratën e Përgjithshme të Komunës së Obiliqit, dhe me datë 21.04.2021 Drejtoresha e Administratës së Komunës së Obiliqit nxjerr vendimin me numër III-125 me të cilin vendim ankuesit i shqipton masën disiplinore "Vërejtje nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë", me arsyetim se me datë 20.04.2021 nga ankuesi ka kërkuar që përkohësisht ti kryej detyrën e nëpunësit të arkivës pasi që nëpunësi i cili i ka kryer këto detyra ka vdekur,

ndërsa ankuesi ka refuzuar që të kryej detyrat e punës pra nuk e ka respektuar urdhrin e drejtorit andaj për shkak të mospërgjegjjes nga ana e tij ka mund të pësoj institucioni.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin me numër III-125 të datës 21.04.2021 të Drejtoreshës së Administratës së Komunës së Obiliqit me datë 05.05.2021 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 2173/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 07.05.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Obiliqit në pajtim me dispozitat e nenit 6 paragrafit 4 të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurat e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Më datë 21.05.2021 Komuna e Obiliqit ka kthyer përgjigje në ankesën e ankuesit duke i bashkangjitur edhe shkresat e lëndës, mirëpo Komuna e Obiliqit ka kthyer përgjigje jashtë afatit ligjor të përcaktuar në nenin 17 paragrafit 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i cili ka përcaktuar se: *“Organi i punësimit është i obliguar që brenda afatit prej pesë (5) ditësh pune, nga dita e pranimit të kërkesës për përgjigje në ankesë, të kthejë përgjigje dhe të ofrojë të gjitha dëshmitë që i kërkon Këshilli”.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova:

Ankesa e ankuesit e datës 05.05.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 21.04.2021 i Drejtoreshës së Administratës në Komunën e Obiliqit; Raporti mjekësor i Elita Plus i datës 22.04.2021; Akt emërimi i ankuesit i datës 03.01.2013; Përshkrimi i detyrave të punës i ankuesit; Deklarata e datës 19.05.2021 e Drejtoreshës së Administratës së Përgjithshme të Komunës së Obiliqit; Kërkesë për pushim vjetor nga data 26/04/2021 gjer më 12/05/2021; Kërkesa për pushim vjetor nga data 19/04/2021 gjer më 30/04/2021; e-mail i datës 09.06.2021 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje në mënyrë meritorë ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit *është e bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës, ka konstatuar se ndaj ankuesit më datë 21.04.2021 Drejtoresha e Administratës së Komunës së Obiliqit ka nxjerr Vendimin me numër III-125 me të cilin vendim ndaj ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore “Vërejtje nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë” për shkak të refuzimit të kryerjes së detyrave të punës së arkivistit nga ana e ankuesit mirëpo nga shkresat e lëndës dhe nga vetë Deklarata e datës 19.05.2021 e Drejtoreshës së Administratës së Komunës së Obiliqit, Kolegji ka konstatuar se Drejtoresha e Administratës e Komunës së Obiliqit me asnjë vendim/akt administrativ apo shkresë zyrtare nuk e ka caktuar ankuesin në kryerjen e detyrave të Arkivistit, por një gjë të tillë e ka kërkuar vetëm gojarisht nga ankuesi dhe i cili ka refuzuar që ti kryej detyrat e Arkivistit për shkaqe shëndetësore.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar, se Drejtoresha e Administratës së Komunës së Obiliqit ka qenë dashtë që me shkrim ta caktoj ankuesin në detyrën e Arkivistit dhe kohën sa do të zgjasë kryerja e detyrave të Arkivistit, pasi që pozita



aktuale të cilën e mban ankuesi "Nëpunës për vërtetimin dhe saktësimin e dokumenteve", në Administratën e Përgjithshme të Komunës së Obiliqit, në bazë të përshkrimit të detyrave të tij të punës është e përafërt me pozitën e Arkivistit, deri sa të plotësohet pozita e lirë e punës e Arkivistit me ndonjë nëpunës tjetër të Komunës së Obiliqit që ka pozitë të përafërt dhe që gëzon shëndet të mirë shëndetësor pasi që ankuesi në Këshill ka sjell raport mjekësor që vuan nga disa sëmundje gjë të cilën e ka pranuar edhe Drejtoresha e Administratës së Përgjithshme që është në dijeni për sëmundjen e ankuesit që vuan nga sheqeri.

Kolegji për shqyrtim dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se nuk iu është e dhënë e drejta që të ankohet brenda institucionit por që është udhëzuar që të bëjë direkt ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit nuk është i bazuar pasi që me dispozitat ligjore të nenit 24 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë është përcaktuar se: *"Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji..."*


Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.357/2021, datë 11/06/2021.

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

Procesmbajtëse

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Obiliqit;
- Udhëheqësit të Burime Njerëzore të Komunës së Obiliqit;
- Arkivit të KPMSHC-së.

